REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 5591 Prot

Maliq, më 22.9.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 9, datë 22.09. 2026

PËR

"Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë", i ndryshuar"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 29/1, shkronja "a", neni 54, shkronja "ç", ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 *"Për klasifikimin e e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendor, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.05.2023 *"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike"*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "*Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë"*, i ndryshuar,

PROPOZOJ:

I. Të miratoj disa shtesa dhe ndryshime në strukturën organizative të Bashkisë Maliq si më poshtë:

1- Në strukturën e Administratës së Bashkisë Maliq (qëndër), në lidhja nr. 1 të bëhen disa ndryshime si më poshtë:

- Në "*Drejtorinë e të Ardhurave*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës "***Përgjegjës Sektori***" në Sektorin e Regjistrim, Vlerësimit, Klasa III-3, me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **85,000** (*tetëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë;

- Në "*Drejtorinë e Pronave Publike dhe Aseteve*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës "***Specialist Strehimi***" në Sektorin e Strehimit, me nr. rendor 8 në këtë drejtori,

Klasa IV-3, me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **55,000** (*pesëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë.

2- Në strukturën e "*Arsimi Parashkollor + Mbështetës*", të bëhen disa shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

- Në strukturën "*Punonjës mbështetës Arsimi 9-vjeçar + Parashkollor*", të hiqet pozicioni i punës "***Sekretare***", Shkolla Rëmbec, Klasa VII, paga për pozicion **53,600** (*pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë;

- Në strukturën "*Punonjës mbështetës Arsimi 9-vjeçar + Parashkollor*", të shtohet pozicioni i punës "***Sekretare***", Shkolla Zvezdë + Shëngjergj, Klasa VII, paga për pozicion **53,600** (*pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë.

3- Në strukturën e "*Arsimi i Mesëm + Punonjës Mbështetës*", të shtohet pozicioni i punës "***Sekretare***", Shkolla Rëmbec, Klasa VIII, paga për pozicion **54,100** (*pesëdhjetë e katër mijë e njëqind*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë.

II. Efektet financiare fillojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për vitin 2026.

III. Për nxjerrjen e urdhrit për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Konceptoi: N. Çaushi Dt. 23/09/2026

A. Muka _____ Dt. ___/___/2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 5591 Prot. Maliq, më 22.9.2026

RELACION

Për
"Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë" i ndryshuar"

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Maliq

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 29/1, shkronja "a", neni 54, shkronja "ç", ligjin nr.152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 *"Për klasifikimin e e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendor, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeeverisajes vendore*", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.05.2023 *"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike"*, i ndryshuar,Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 87, datë 06.02.2026 "*Për disa ndryshime në Vendimin nr. 326, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike", të ndryshuar*",

Sipas projekt-vendimit të paraqitur, propozohet që në strukturën organizative të Bashkisë Maliq miratohen disa shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

1- Në strukturën e Administratës së Bashkisë Maliq (qëndër), në lidhja nr. 1 të bëhen disa ndryshime si më poshtë:

- Në "*Drejtorinë e të Ardhurave*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës "***Përgjegjës Sektori***" në Sektorin e Regjistrim, Vlerësimit, Klasa III-3, me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **85,000** (*tetëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë;

  Argumentimi : Ndryshimi i pagës për këtë pozicion pune bëhet për efekt të ngarkesës që ka ky sektor. Për këtë pozicion pune do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

- Në "*Drejtorinë e Pronave Publike dhe Aseteve*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës "***Specialist Strehimi***" në Sektorin e Strehimit, me nr. rendor 8 në këtë drejtori, Klasa IV-3, me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **55,000** (*pesëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë.

Argumentimi : Ndryshimi i pagës për këtë pozicion pune bëhet për efekt të ngarkesës që ka ky sektor. Për këtë pozicion pune do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

2- Në strukturën e "*Arsimi Parashkollor + Mbështetës*", të bëhen disa shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

- Në strukturën "*Punonjës mbështetës Arsimi 9-vjeçar + Parashkollor*", të hiqet pozicioni i punës "***Sekretare***", Shkolla Rëmbec, Klasa VII, paga për pozicion **53,600** (*pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë;

  Argumentimi : Ky pozicion hiqet nga struktura e "*Arsimi Parashkollor + Mbështetës*" dhe shtohet te struktura përkatëse "*Arsimi i Mesëm + Punonjës Mbështetës*".

- Në strukturën "*Punonjës mbështetës Arsimi 9-vjeçar + Parashkollor*", të shtohet pozicioni i punës "***Sekretare***", Shkolla Zvezdë, Klasa VII, paga për pozicion **53,600** (*pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë.

  Argumentimi : Kjo shtesë pozicioni pune bëhet për efekt të nevojës për sekretare në Shkollën Zvezdë, ku gjithashtu do të mbulojë dhe shkollat në varësi në fshatin Shëngjergj dhe Burimas. Për pozicionin e punës që shtohet do të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

3- Në strukturën e "*Arsimi i Mesëm + Punonjës Mbështetës*", të shtohet pozicioni i punës "***Sekretare***", Shkolla Rëmbec, Klasa VIII, paga për pozicion **54,100** (*pesëdhjetë e katër mijë e njëqind*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë.

   Argumentimi : Ky pozicion nuk është pozicion i ri, por është pozicioni që hiqet nga struktura e "*Arsimi Parashkollor + Mbështetës*" dhe shtohet te struktura përkatëse "*Arsimi i Mesëm + Punonjës Mbështetës*". Për pozicionin e punës që shtohet do të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

4- Efektet financiare fillojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për vitin 2026.

Në kompetencën Tuaj ligjore, përcaktuar në nenin 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", gërma (ç), të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, ju paraqesim për miratim e projekt-vendimit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj!

Konceptoi: N. Çaushi _____ Dt. 23/09/2026

A. Muka _____ Dt. ____/____/2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu